



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.15.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni (udhëheqës i ekipit), Florë Berisha dhe Agim Sogojeva (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
5 Qeverisja e mirë.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	25
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	27
Shtojca III: Letërkonfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 06/10/ 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar në varësi të cilësisë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se, shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve kontigjente nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Drejtësisë (MD). Ne kemi analizuar veprimtarinë e MD-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e pasurive me vlerë nën 1,000€ e shpalosur në PFV nuk është e saktë pasi që nuk është bërë zhvlerësimi i plotë i pasurive në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK). Kjo gjendje është përseritur nga vitet paraprake dhe ka rrjedhur si pasojë e mos funksionimit të mirëfilltë të sistemit e-pasuria. Megjithë përpjekjet e menaxhmentit për ta korrigjuar këtë defekt, në disa njësi të Ministrisë ishte korrigjuar por jo edhe në SHKK.

Përveq kësaj, në PVF ishin shpалosur detyrime kontigjente në vlerë prej 586,062€. Mirëpo gjatë testimeve kemi vërejtur se kjo vlerë nuk është e saktë, ngase aty janë përfshirë edhe raste të mbyllura gjyqësore të cilat janë paguar në vitet paraprake. Kjo ka ndodhur si pasojë e ofrimit të informatave jo të sakta nga ana e Avokaturës Shtetërore, dhe për shkak të mungesës së analizimit adekuat të këtyre informatave.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MD-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të, në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MD kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF, Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare Nr.01/2013 dhe Nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Draft planin dhe planin përfundimtar i prokurimit;
- Raportet financiare tremujore; dhe
- Raportet operative.

Si pasojë e korrigjimeve në SIMFK, MD ka diskutuar me Thesarin, dhe i ka korrigjuar PFV-të me datën 13.03.2018. Megjithatë çështjet e ngritura si theksim i çështjes nuk ka qenë e mundur të korrigohen.

Prandaj, deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, me përjashtim të rasteve të potencuara tek theksimi i çështjes, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ti eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontigjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin dhe shpalosjen e saktë të pasurive jokapitale. Në këtë drejtim, departamentit të financave duhet ti ofrohen shënimet e sakta rreth detyrimeve kontigjente. Njëkohësisht departamenti i financave duhet ti analizojë mirë shënimet, para se ato të shpalosen në PFV.

Rekomandimi 2 Po ashtu, Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Përkundër faktit se MD ka vendosur kontrole relativisht të mira në raport me obligimet statutorë të saj, mos zbatimi me konsistencë i kërkesave, ka shkaktuar mangësi në procesin e pagesave, menaxhim jo të mirë të pasurive etj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli duhet të dëshmojnë proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, vonesat në realizimin e pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pagesa e shtesave pa bazë të qartë ligjore, mos kthimi i parave për të burgosurit e liruar, dhe menaxhimi i pasurive nën 1,000€, në SHKK.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	20,854,714	18,723,099	18,009,002	18,671,373	18,282,610
Granti i Qeverisë -Buxheti	20,774,514	18,596,025	17,977,959	18,167,651	18,223,247
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	6,772	42	0	0
Të hyrat vetjake ³	80,200	80,200	19,904	51,224	28,490
Donacionet e jashtme	0	40,102	11,097	452,498	30,873

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,131,615€. Ky zvogëlim është si pasojë e shkurtimeve buxhetore që janë bërë me Vendime të Qeverisë.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Ministrisë të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2017, MD kishte shpenzuar 96% të buxhetit final, me një rënie për 3% në krahasim me vitin e kaluar ku shpenzimi ishte 99% e buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	20,854,714	18,723,099	18,009,002	18,671,373	18,282,610
Pagat dhe Mëditjet	12,683,196	12,308,891	12,238,865	12,258,365	11,989,837
Mallrat dhe Shërbimet	4,657,349	4,604,028	4,156,386	4,750,087	4,497,472
Shërbimet komunale	922,169	1,095,479	1,042,211	968,009	1,051,136
Subvencionet dhe Transferet	1,500,000	132,376	99,876	9,900	0
Investimet Kapitale	1,092,000	582,325	471,664	685,012	744,165

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Te pagat dhe mëditjet buxheti final ishte zvogëluar për 374,305€. Kjo ka ndodhur pasi që me Ligjin e buxhetit për vitin 2017 kanë qenë të parapara 70 pozita për oficerë korrektues, mirëpo gjatë vitit 2017 nuk ishin zhvilluar procedurat e rekrutimit, andaj Qeveria i ka marrë këto mjete nga buxheti i MD-së në emër të kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 53,321€, në krahasim me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim ka rrjedhur si rezultat i rishikimit të buxhetit si dhe vendimeve të mëvonshme të Qeverisë;
- Buxheti final për shërbime komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 173,310€. Nevoja për shtim të mjeteve në këtë kategori ka rrjedhur si pasojë e e lëshimit në përdorim të Qendrës së paraburgimit në Gjilan, dhe Qendrës për të mitur në Lipjan;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 1,367,624€ me Vendim të Qeverisë. Duhet të theksohet se komplet shuma prej 1,500,000€ ishte ndarë për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare për Personat e Akuzuar për Krimet e Pretenduara nga Gjykata Speciale, e cila ende nuk kishte filluar punën, dhe ky buxhet nuk ishte shpenzuar. Është shpenzuar vetëm një pjesë e buxhetit (shpjegimet e detajuara janë dhënë tek nënkapitulli 3.6);
- Buxheti final i investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 509,675€, nga këto 328,800€ me vendim të Qeverisë nr. 08/151 të datës 02.08.2017, ndërsa 180,875€, po ashtu me vendim të Qeverisë në emër të kursimeve buxhetore. Pavarësisht zvogëlimit të buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 81% e buxhetit ishte shpenzuar.

Çështja 3 – Realizimi i buxhetit

E gjetura Realizimin e buxhetit për investime kapitale mbetet sfidë me të cilën përballet në vazhdimësi MD-ja. Buxheti final për investime kapitale është realizuar rreth 81%. Megjithatë buxheti final në këtë kategori ishte reduktuar për 509,675€. Kjo çështje ishte trajtuar në raportet e auditimit të viteve paraprake, mirëpo ende nuk është adresuar nga menaxhmenti.

Për më tepër, dinamika e shpenzimit të buxhetit nuk ishte në harmoni me planin e rrjedhës së parasë, pasi që rreth 92% e buxhetit ishte shpenzuar vetëm në tremujorin e fundit. Arsye për këtë ishin vonesat në inicimin e procedurave të prokurimit, anulimi i procedurave të prokurimit, vonesat në realizimin e punimeve për shkak të specifikave që i kanë burgjet etj.

Rreziku Realizimi i ulët i buxhetit mund të rezultoj në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit pasues. Në anën tjetër niveli i lartë i shpenzimeve kapitale në fund të vitit rrezikon që pagesat t'i shmangen kontrolleve të duhura gjatë procesit të ekzekutimit.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike, në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar, me fokus të veçantë në projektet kapitale.

3.2 Të hyrat dhe depozitat

Të hyrat e realizuara nga MD në vitin 2017 ishin në vlerë 198,284€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat që realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të gjykatave, të hyrat nga organizimi i provimeve profesionale për jurisprudencë, përmbarues privat dhe administrator falimentues etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	80,200	80,200	198,284	201,863	349,455
Totali	80,200	80,200	198,284	201,863	349,455

Të hyrat e arkëtuara në vitin 2017 ishin 198,284€. Me Ligjin e Buxhetit të vitit 2017 janë lejuar të shpenzohen për nevojat e MD-së 80,200€, prej të cilave janë shpenzuar 19,949€. Pjesa tjetër janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

Përveq të hyrave, MD menaxhon edhe depozitat/paratë e të burgosurve (të cilat menaxhohen nga SHKK) dhe depozitat e sekuestruara të cilat menaxhohen nga AAPSK. Vlera totale e depozitave të regjistruara në SIMFK gjatë vitit 2017 ishte 1,665,284€.

Çështja 4 – Depozitat bankare

E gjetura Sipas Ligjit mbi sanksionet penale dhe rregullës financiare 09/2012 për fondet në mirëbesim, SHKK është përgjegjëse për mbajtjen e evidencës së pranimeve, kthimeve si dhe për gjendjen e depozitave të të burgosurve. Aktet e lartëcekura poashtu përcaktojnë që sendet personale dhe paratë e deponuara duhet t'u kthehen të burgosurve pas lirimit të tyre.

Ne kemi vërejtur që paratë e të burgosurve në vlerë prej 32,647€ nuk u ishin kthyer të burgosurve pas lirimit. Vetëm në Qendrën Korrektuese të Dubravës vlera e depozitave që nuk janë kthyer ishte 17,553€.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, këto mjete nuk janë kthyer, për arsye se disa nga të burgosurit pas lirimit, nuk janë interesuar për mjetet të cilat ju kanë mbetur si depozita.

Rreziku Mos kthimi i mjeteve të të burgosurve të cilët i përfundojnë dënimet apo lirohen, është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme. Kjo poashtu e rritë rrezikun që këto mjete t'i ekspozohen keqpërdorimit.

Rekomandimi 4 Ministri nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së duhet të sigurojnë që zyrtarët përkatës të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e parave të të burgosurve, me rastin e përfundimit të dënimeve, secilit person të liruar nga burg u kthejnë mjetet të cilat i kanë në depozitë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MD-së, e të cilat ndërliken me përcaktimin e koeficientëve të pagave, avancimin dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme. Në këtë kategori të shpenzimeve ishin shpenzuar 12,238,865€ apo 99% e buxhetit final.

Çështja 5 - Kompensimi i shtesave në kundërshtim me vendimet si dhe mos zëvendësimi i kontratave të shërbyesve civil me akt-emërime

E gjetura Sipas neneve 96 dhe 97 të LShC, ishte paraparë që të gjitha kontratat e punës në shërbimin civil të Kosovës për pozitat të cilat për nga natyra, funksioni dhe detyrat janë pozita të përhershme, të zëvendësohen me akt-emërime.

Ne kemi identifikuar 11 raste në SHKK, në të cilat zyrtarëve nuk u janë zëvendësuar kontratat me akt-emërime. Udhëheqësi i Personelit përmes shkresës zyrtare në janar 2016 e kishte njoftuar drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së, se të gjitha akt-emërimet lidhur me zëvendësimin e këtyre kontratave janë përgatitur dhe presin nënshkrimin e tyre, megjithatë deri në fund të vitit 2017 nuk ishin nënshkruar akt-emërimet.

Zyrtarët e lartë përmendur, të cilët punojnë në administratën e SHKK-së dhe e kanë statusin e shërbyesit civilë, marrin shtesë nga 107€ për muaj duke u bazuar në vendimin nr.01/1002 të datës 25.06.2009, në të cilin potencohet se shtesa ju takon vetëm oficerëve korrektues të uniformuar të SHKK-së, në emër të kompensimit shtesë për rrezikshmëri në punë.

Për më tepër, në SHKK për pozitën administrator i sistemeve pagesa e shtesës nuk ishte bërë konform vendimit Nr.02/39 të Zyrës së Kryeministrit për pagat dhe shtesat, për kategori të veçanta deficitare në fushën IT-së.

Rreziku Mos zëvendësimi i kontratave të punës me akt-emërime për shërbyesit civilë, paraqet shmangie të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Përveq kësaj, pagesat e shtesave në kundërshtim me vendimet relevante, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të Ministrisë.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojnë respektimin e plotë të dispozitave ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga të gjithë vartësit e tij. Në rastin konkret kontratat e nëpunësve civil duhet të zëvendësohen me akt-emërime, dhe pagesat e shtesave të bëhen konform vendimeve në fuqi. Ndërkohë shtesat e stafit të teknologjisë informative duhet të paguhen në pajtim me vendimet në fuqi.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me, rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

Çështja 6 - Plotësimi i pozitave me ushtrues të detyrës për më gjatë se tre muaj

E gjetura Sipas Ligjit të Shërbimit Civil nr.03-L-149, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ndërsa emërimi i drejtpërdrejtë në pozita të lira, në kundërshtim me parimin e meritës, nuk është i lejueshëm. Ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Në burgun e Sigurisë së Lartë që nga marsi 2016, një zyrtar korrektues është caktuar ushtrues i detyrës i Udhëheqësit të Njësisë për Siguri të Brendshme;
- Zv. Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë (QPM), është caktuar UD i Drejtorit të QPM-së që nga data 06.01.2016;
- Në Qendrën Korrektuese në Dubravë nga pozita Udhëheqës i Administratës, është caktuar UD i zëvendës Drejtorit në QKD, në fund të dhjetorit 2016; dhe
- Në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë një zyrtar i cili ka qenë UD i udhëheqësit për siguri në Zyrën Qendrore të SHKK-së, ishte caktuar më pas UD i Drejtorit të Drejtoratit për Operativë, Siguri dhe Transportim të Burgosurve në Zyrën Qendrore të SHKK-së.

Nuk ka ndonjë arsytim të vlefshëm se pse këto pozita kanë vazhduar të mbahen nga ushtruesit e detyrës.

Rreziku Praktika e mbulimit të pozitave me UD për periudha më të gjata se sa është e lejuar me dispozita ligjore, rrit rrezikun që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme dhe mund të ndikojë në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime konkrete për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me UD. Të rishikohen arsyet e mos angazhimit të personelit të rregullt në këto pozita dhe të vendosen kontrole shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre nuk duhet të jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 5,699,507€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,198,597€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me ushqim për nevojat e të burgosurve, furnizim me material shpenzues, furnizim me materiale mjekësore, si dhe shërbime komunale, prej të cilave pjesa më e madhe tek burgjet si uji, rryma etj. Nga këto shpenzime ne kemi testuar 80 pagesa me vlerë të përbashkët prej 1,258,142€ dhe gjashtë procedura të prokurimit në vlerë 2,147,144€. Testimet tona kanë rezultuar me disa mangësi ndërlidhur më procesin e pagesave.

Çështja 7 – Mangësi në procesimin e pagesave

E gjetura Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton se “të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore, duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë”.

Në SHKK, kemi vërejtur se në 30 raste pagesat me vlerë të përbashkët prej 529,809€ janë kryer pas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh. Vonesat kryesisht janë prej 30 deri në 60 ditë përtej afatit të paraparë ligjor, derisa kjo çështje, është përsëritur nga vitet paraprake. Si arsyetim për këtë zyrtarët e SHKK-së theksuan që gjatë vitit 2017 ishin përballur me vështirësi të alokimit të mjeteve me kohë dhe me probleme me sistemin e thesarit për të realizuar pagesat.

Përveq kësaj, sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Në 36 raste konstatuam se, në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër-blerja.

Rreziku Vonesat në realizimin e pagesave mund të ndikojnë në mos-implementimin e kontratave me kohë, dhe rrisin rrezikun për pagesa të ndëshkimeve potenciale nga operatorët ekonomik. Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë me obligime të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi 7 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së duhet të sigurojnë funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare për kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë, si dhe të bëjnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 132,376€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 99,876€. Shuma prej 40,000€ ishte paguar për projektin “Ndërtimi i Ujësjetës për Furnizim me ujë të Qendrës së Paraburgimit në fshatin Pasjak të Gjilanit”, 40,000€ tjera me vendim të Qeverisë ishin dhënë si donacion për renovimin shkollës fillore në fshatin Somolicë të Bujanocit. Më tutje, shuma prej 14,376€ janë shpenzime të ekzekutuara nga MF/Thesari sipas kërkesës së Përmbartës Privat/Vendim Gjykatë, dhe 5,500€ janë transfere për kompensimin e viktimave të krimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 582,325€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 471,664€. Ato kanë të bëjnë me rregullimin e burgjeve, krijimi i hapësirave për trajnime, dhe blerjen e pajisjeve për laboratorin e toksikologjisë. Ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje materiale që duhet raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PVF-të e MD-së janë prezantuar 94,496,664€ pasuri kapitale (me vlerë mbi 1,000€) dhe 1,881,926€ pasuri jo kapitale (me vlerë nën 1,000€). Vlen të theksohet se në Ministri dhe në Agjencionin për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, ka pasur progres në menaxhimin e pasurive, ku është përmirësuar procesi i zhvlerësimit të pasurive me vlerë nën 1,000€. Mirëpo e njëjta nuk mund të thuhet për SHKK, ku vazhdon të ketë probleme në këtë pjesë. Auditimi ynë bërë pasurisë, ka identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 8 – Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurive

- E gjetura** Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se “Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare”. Ne kemi vërejtur se Ministria nuk kishte procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë.
- Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e Ministrisë mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejt.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë që është bërë aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.

Çështja 9 – Mangësi në menaxhimin e regjistrave dhe në inventarizimin e pasurive

- E gjetura** Në vitin 2017, MD dhe agjencitë e saj kishin kryer inventarizimin e pasurive. Gjatë këtij procesi janë identifikuar pasuri të cilat nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria. Në SHKK, komisioni për inventarizimin e pasurisë nuk e kishte kryer punën konform Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare pasi që, raportin për inventarizim e kishte dorëzuar me datën 09.03.2018, që nënkupton se nuk është bërë harmonizimi me pasqyrat financiare vjetore dhe gjendja e pasurive e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë. Po ashtu komisioni ka identifikuar se një numër i konsiderueshëm i asetëve nuk kanë barkode, dhe nuk është bërë shkarkimi nga e-pasuria i disa zyrtarëve të cilët janë transferuar me vendime të Sekretarit të Përgjithshëm nga një departament në tjetrin.
- Rreziku** Mangësitë në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe inventarizimi i pasurive jo në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive, rrit rrezikun që informatat në PFV të mos jenë të sakta. Mos evidentimi i pasurive të caktuara në evidencat e pasurive, shton rrezikun që pasuritë të humbin apo ti ekspozohen përvetësimi/keqpërdorimit eventual.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare ta kryej punën në pajtim me rregulloren duke përfshinë dhe vlerësuar të gjithë pasurinë e Ministrisë.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,034,486€. Prej tyre 843,476€ për mallra dhe shërbime, 190,470€ për shërbime komunale dhe 540€ për transfere. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

Çështja 10 - Vonesa në kryerjen e obligimeve si dhe raportim jo i drejtë në PFV

E gjetura Shuma e shpalosur në PFV prej 1,034,486€ paraqet menaxhim jo të mirë të obligimeve të papaguara. Kjo gjendje është shkaktuar nga vonesat në pagesën e faturave. Faturat e testuara në vlerë prej 147,362€ nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh, siç përcaktohet me dispozitat ligjore.

Rreziku Mos kryerja e obligimeve sipas afateve të parapara ligjore, rritë rrezikun që borxhet të rriten dhe kjo pastaj e sjellë Ministrinë në vështirësi financiare. Njëkohësisht kjo situatë mund të sjellë konteste apo keqkuptim të vlerave financiare në PFV.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të promovojë mekanizma shtesë për të siguruar që të gjitha faturat e pranuar do të procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë ligjor, dhe të vendosë kontrolle efikase sa i përket identifikimit, regjistrimit, procedimit të pagesave dhe raportimit të detyrimeve të papaguara.

3.10 Detyrimet Kontingjente

Ministria e Drejtësisë ka prezantuar detyrime kontingjente në PVF vlerën 586,062€. Këto janë pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa që në të ardhmen të krijojnë detyrime financiare për MD-në varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse.

Çështja 11 - Menaxhim i dobët i informatave nga Avokatura Shtetërore

E gjetura Konform Standardeve të Kontabilitetit dhe Raportimit, Organizatat Buxhetore janë të obliguara që në PFV, përveq tjerash të shpalosin edhe informata në lidhje me detyrimet kontigjente⁴. Sipas Ligjit Nr.04/L-157, Avokatura Shtetërore, është mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i përfaqësimit të pavarur ligjor të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës në procedurat gjyqësore, të arbitrazhit dhe administrative. Rrjedhimisht Avokatura Shtetërore do të duhej që ti ketë informatat e sakta në lidhje me kontestet dhe paditë ndaj Institucioneve të cilat i përfaqëson. Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se Avokatura Shtetërore posedon informata në lidhje me të gjitha lëndët ku ka qenë përfaqësuese, megjithatë këto informata nuk janë sistemuar mjaftueshëm për të na shërbyer neve si bazë krahasuese e detyrimeve kontigjente të shpalosura në PFV nga OB-të. Kjo ngase përveq evidentimit si raste kontestuese/padi, në regjistrin e lëndëve mungojnë informata të tilla si: kush është paditësi, kush është i padituri, në cilën fazë gjendet lënda, në shumë raste nuk ka ndonjë vlerë të përafërt të dëmit/përfitimit të mundshëm etj. Përveq kësaj linjat e komunikimit ndërmjet Avokaturës Shtetërore, Institucioneve që Përfaqësohen dhe Gjykatave, nuk janë shumë funksionale.

Rreziku Mungesa e informatave të plota rreth rasteve/padive, e rritë rrezikun që prezantimi i detyrimeve kontigjente në PVF-të e OB-ve të mos jetë i saktë dhe mos të dihet gjendja reale e lëndëve që janë në procedura gjyqësore. Përveq kësaj kjo paraqet menaxhim jo të duhur të informatave nga ana e Avokaturës Shtetërore dhe dëmton kredibilitetin e saj.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të inicojë një rishikim të funksionimit të databazës aktuale, për të përcaktuar shkaqet e mosfunksionimit efikas të saj, dhe njëkohësisht duhet të ndërmerren masat e nevojshme që menaxhimi i informatave në fjalë të përmirësohet. Kjo do të mundësonte që Ministri dhe Avokatura Shtetërore të kenë informatat e sakta në lidhje me rastet që i përfaqësojnë, dhe njëkohësisht ju ndihmon OB-ve që ti kenë informatat e sakta në lidhje me detyrimet kontigjente.

Përveq kësaj Ministri duhet të rishikojë formën aktuale të komunikimit të Avokaturës Shtetërore me Institucionet që ajo i përfaqëson, dhe të nxisë një bashkëpunim më të afërt dhe efikas, në mënyrë që palët ti kenë informatat në kohën e duhur në lidhje me kontestet dhe paditë.

⁴ Detyrimet kontigjente janë obligime të mundëshme financiare të cilat mund të rrjedhin në të ardhmen si rezultat i padive dhe kontesteve të ndryshme.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 kishte rezultuar me 11 rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime ishin zbatuar, tri ishin në proces dhe gjashtë të tjerat nuk ishin zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe shtatë rekomandime (gjashtë të pa zbatuara dhe një në zbatim e sipër). Gjatë vitit 2017 tri nga këto rekomandime ishin në proces të zbatimit derisa katër tjera nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 12 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Edhe pse menaxhmenti kishte bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve ende nuk kishte arritë që ti adresoj në nivelin e kënaqësëm. Kjo për shkak të mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të viteve paraprake ndikon në vazhdimin e dobësive në kontrollet e brendshme duke rezultuar në:

- Vonesa në kryerjen e obligimeve ndaj operatorëve ekonomikë;
- Vazhdimi i mbulimit të pozitive më UD në SHKK edhe pse ka qenë rekomandim në raportet e viteve paraprake;
- Mos kthimi i parave të burgosurve me rastin e lirimit të tyre; dhe
- Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblereve pas pranimit të mallrave.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve të brendshme, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e Zyrtarit Kryesor Administrati me auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e mirë të pasurisë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohen nga të gjitha OB-të, e të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MD ka shënuar progres në qeverisje, duke bërë disa përmirësime në sistemet e kontrollit të brendshëm, ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, ku janë identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim në arritjen e objektivave të organizatës, si dhe masat për zbutjen e rreziqeve. Megjithatë janë disa fusha ku nevojiten veprime përmirësuese. Menaxhimi i regjistrave të pasurive nën 1,000€, menaxhimi i depozitave si dhe procesimi i pagesave duhet të përmirësohen. Poashtu edhe tek obligimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente duhet të shtohet fokusi. Adresimi i plotë dhe cilësor i rekomandimeve tona mbesin ende sfidë për MD-në. Auditimi i brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre, por kjo duhet të mbështetet edhe me veprime korigjuese nga ana e menaxhmentit.

Ministria ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik (2018-2021), Strategjinë Nacionale të Drejtave Pronësore për vitet 2016-2019, Strategjinë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Planin e Veprimit 2016-2020. Implementimi i tyre kërkon kontrolle të brendshme efikase dhe respektim të procedurave ligjore. Prandaj nevojitet përkushtim maksimal i menaxhmentit për ti arritur synimet dhe objektivat e përcaktuara.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera, të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Për vitin 2017, në bazë të vlerësimit të rrezikut, ishin planifikuar tetë auditime të rregullta (gjashtë me rrezik të lartë, dhe dy me rrezik të mesëm), si dhe një auditim sipas kërkesës. Ky plan ishte realizuar plotësisht. Aktivitetet audituese kanë mbuluar aktivitetet e vitit 2016 dhe 2017, në fushën e të hyrave, shpenzimeve në SHKK, menaxhimin e pasurisë dhe logjistikës, menaxhimin e personelit, menaxhimin e veturave, buxhetin dhe shpenzimet e përgjithshme, fondin privat të të burgosurve, si dhe procedurat e prokurimit.

Ne vlerësojmë punën e bërë nga NjAB dhe konkludojmë se raportet ishin cilësore, të mbështetura me dëshmi adekuate, kanë identifikuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e mangësive të identifikuara.

Komiteti i Auditimit (KA), ka mbajtur katër takime ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, dhe është diskutuar për raportin e auditimit të PFV-ve të MD-së të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk ishte i knaqshëm.

Çështja 13 – Rekomandimet e NJAB-së vetëm pjesërisht të zbatuara

E gjetura Rekomandimet e NJAB-së ishin zbatuar vetëm pjesërisht nga ana e menaxhmentit të Ministrisë. Ketë e vërteton edhe Raporti vjetor i NjAB-së, i dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Nevojitet punë më cilësore dhe më e theksuar e KA-së në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Rreziku Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve të NJAB-së nga menaxhmenti, rrit rrezikun që mangësitë e kontroleve të brendshme, të identifikuara nga auditimi të mos përmirësohen dhe rrjedhimisht të ndodhin lëshime dhe gabime përgjatë zhvillimit të aktiviteteve të Ministrisë. Kjo poashtu e zvogëlon cilësinë e performancës së Ministrisë në tërësi.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme për të inkurajuar menaxhmentin dhe njësitë administrative që ti zbatojnë rekomandimet e NjAB-së, në mënyrë që të përmirësohen fushat ku janë identifikuar mangësi.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk kanë dhënë përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

MD ka dizajnuar sisteme relativisht të mira të kontrollit të brendshëm⁵ dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Megjithatë ka mungesë të legjislacionit sekondar për sistematizimin e vendeve të punës në SHKK përkundër që kërkohet me ligj. Kjo mund të ketë ndikuar që kontrollet e brendshme në SHKK, të mos funksionojnë me efikasitetin e duhur.

MD ka plotësuar kërkesat e MFK-së duke e hartuar matricën e rreziqeve të mundshme, ku janë përfshirë: identifikimi, vlerësimi, trajtimi i rreziqeve, si dhe analizimi dhe raportimi përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve. Janë përcaktuar edhe llojet, gjasat e ndodhjes së rreziqeve, veprimet që do të ndërmerren nga departamentet përkatëse dhe afatet brenda të cilave do të bëhet monitorimi tyre, mirëpo ky monitorim nuk ishte bërë.

Çështja 14 - Mungesa e monitorimit të rreziqeve

E gjetura Regjistri i rrezikut duhet të rishikohet rregullisht (rekomandohen rishikime tremujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprimet ashtu siç është planifikuar dhe nëse është bërë ndonjë ndryshim në vlerësimet e rrezikut. Regjistri i rishikuar i rrezikut, duhet të nxirret pas secilit rishikim dhe të azhurnohet sipas nevojës, mirëpo ne kemi identifikuar se gjatë vitit 2017 kjo listë nuk ishte rishikuar në baza tremujore dhe nuk ishte monitoruar siç kërkohet me procedurat e MFK-së.

Rreziku Mungesa e monitorimit/rishikimit të vazhdueshëm të rreziqeve nga ana e menaxhmentin rritë rrezikun që objektivat e organizatës të mos arrihen. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të siguroj që lista e rreziqeve të monitorohet në vazhdimësi, në baza tremujore, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, si dhe të merren masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

⁵ Për qëllime të auditimit të PVF-ve, ne nuk kemi arritur të marrim mbështetje në kontrollet e brendshme për shkak se ato nuk i kanë adresuar plotësisht pohimet e auditimit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprakë	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Plani nuk ishte rishikuar formalisht, megjithatë disa nga rekomandimet ishin zbatuar.	
2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për të nxjerrë akte nënligjore të cilat e rregullojnë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministri.			Pa zbatuar
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit të buxhetit. Po ashtu, duhet siguruar se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuar në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.			Pa zbatuar
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj rritjen e efikasitetit në funksionimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese në mënyrë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme të ndara për pagesën e tyre.			Pa zbatuar

3.4.1 Vonesa në realizimin e pagesave	Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Pa zbatuar
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të zhvlerësimit. Në rast nevoje zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.		Pjesërisht i zbatuar-megjithëse ka filluar të përmirësohet gjendja në disa njësi të Ministrisë, në SHKK vazhdon të ketë probleme me zhvlerësimin dhe me sistemin e-pasuria.	
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohen regjistrin i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit. Nëse konstatohen diferenca atëherë duhet të jepen sqarime për ndryshimet e paraqitura.		Pjesërisht i zbatuar pasi që edhe më tutje në SHKK nuk është bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e përgjithshëm të pasurive.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për përcaktimin e shkaqeve për theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet dhe t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të tyre. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PFV-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.		Pjesërisht i zbatuar - edhe më tej ka probleme me zhvlerësimin e pasurive dhe nuk është e saktë vlera e prezantuar në PFV.	

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe do të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.		Pjesërisht i zbatuar pasi që edhe më tutje një pjesë e rekomandimeve nuk janë adresuar.	
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të sigurohet se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për të adresuar rekomandimin e dhënë, për të nxjerrë akte nënligjore të cilat e rregullojnë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në SHKK.			Pa zbatuar
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit/realizimit të buxhetit. Po ashtu, duhet siguar se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.			Pa zbatuar
3.1.1 Të hyrat dhe depozitat (fondet në mirëbesim)	Ministri duhet të siguroj monitorim të rregullt të kësaj llogarie/depozitave nga zyrtarët përgjegjës, dhe kthimin me kohë të mjeteve për secilin të burgosur me rastin e përfundimit të dënimeve.			Pa zbatuar

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmer veprime për të ndërprerë mbulimin e pozitive menaxheriale me UD. Kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore. Po ashtu të siguroj që vlerësimet vjetore për të punësuarit janë kryer me kohë.			Pa zbatuar
3.1.3. Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale- Marrëveshjet për shërbime të veçanta	Ministri duhet të siguroj se janë marrë veprime për të ndërprerë praktikatat e angazhimeve/rekrutimeve të tilla në mungesë të procedurave në mënyrë që të evitohen pagesat e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime.	Është zbatuar		
3.1.3.1 Vonesë në realizimin e pagesave	Ministri duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Pa zbatuar
3.1.3.2 Pranimi i mallrave para zotimit të mjeteve dhe nxjerrjes së urdhër blerjes	Ministri duhet të sigurojë që kontrollat në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.			Pa zbatuar
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollat në menaxhimin e pasurisë. Në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohet regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit. Nëse konstatohen diferenca atëherë duhet të jepen sqarime për ndryshimet e paraqitura.		Pjesërisht i zbatuar, pasi që edhe më tutje në SHKK nuk është bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e përgjithshëm të pasurive.	

3.3 Obligimet e papaguara	Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të sigurojnë kontrolle shtesë në raportimin e obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, të gjitha masat e nevojshme duhet të merren për forcimin e kontrolleve për këto procese.	Është zbatuar		
---------------------------	--	---------------	--	--

Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-1625
 Data / Datum / Date: 02 / 05 / 20 18
 Shtojca / Dodaci / Annex: -1-
 PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE: RAUJAR/DREZUAR: 02.05.2018
 DATE: PRIMALJEN/DOSTAVLJEN:
 DATE: RECEIVED/SUBMITTED:

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqëve Br. Stranica No. Pages
03	401	603	1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë (MD), për vitin 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Abelard Tahiri

Ministër i Drejtësisë

Data: 02.05.2018, Prishtinë

